

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja Raima Elezi, si kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarëve profesional Teuta Krusha dhe Nazim Vilaqo, si anëtarë, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Valdete Zurnaxhiu, në lëndën penale kundër të akuzuarve M. El nga Suhareka, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KP-së, Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2.1 të KP-së; H. M nga fshati Komuna e Suharekës, B. K nga fshati Komuna e Suharekës dhe R. F nga fshati Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2.1 lidhur me neni 31 të KP-së, duke vendosur sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda PP nr. 154/15 dt. 12.02.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Sefer Morina, të akuzuarve, mbrojtësve të tyre av. N. H, D. F, nga Suhareka, H. K, H. C dhe R. T të gjithë nga Prizreni, përfaqësuesi i Komunës e Suharekës Salajdin Gallapeni me datë 19.12.2016, mori këtë:

## AKT GJYKIM

## Ndaj të akuzuarve

M. El, nga i ati R. El dhe e ëma S. El e lindur K. El, i lindur me datë 19.12.1980 në Prizren, me banim në Suharekë, i martuar babë i pesë fëmijëve, ka të kryer fakultetin Ekonomik, pronar i fermës ndërtimore në Suharekë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal 123456789, ka qenë në paraburgim prej datës 27.05.2015 deri më datën 12.06.2015 dhe nën masën e arrestit shtëpiak deri më datën 25.06.2015.

K. F, nga i ati M. F dhe e ëma Q. F e lindur Z. F, i lindur me datë 19.12.1980 në fshatin Komuna e Suharekës, ku edhe tani jetonë, i martuar babë i dy fëmijëve, ka të kryer fakultetin Teknik, mësimdhënës në shkollën e mesme Tenike në Suharekë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal 123456789, ka qenë në paraburgim prej datës 27.05.2015 deri më datën 12.06.2015 dhe nën masën e arrestit shtëpiak deri më datën 25.06.2015.

H. M, nga i ati M. M dhe e ëma M. M e lindur I. M, i lindur me datë 19.12.1980 në fshatin Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, i martuar babë i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme teknike, inspektor i ndërtimtarisë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal 123456789.

B. K, nga i ati Q. K dhe e ëma R. K e lindur K. K, i lindur me datë 19.12.1980 në fshatin Komuna e Suharekës, ku edhe tani jetonë, i martuar babë i dy fëmijëve, ka të kryer fakultetin e Arkitekturës, inspektor i ndërtimtarisë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal 123456789.

R. M. F. ..., nga i ati I. ... dhe e ëma H. ... e lindur S. ..., i lindur me datë 18.01.1961 në fshatin Beqar Komuna e Suharekës, ku edhe tani jetonpë, i martuar babë i gjashtë fëmijëve, ka të kryer fakultetin Juridik, inspektor i ndërtimtarisë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal ...

Konformë nenit 363 par. 1 pika 1.1 të KPP-së

## REFUZOHET AKUZA

I akuzuari M. ...

Se gjatë vitit 2011 në vazhdimësi deri në muajin maj të vitit 2015, në Suharekë, në cilësinë e personit zyrtar – drejtorit të klubit fudbolistik “...”, duke shfrytëzuar detyrën zyrtare i tejkalon kompetenca e tija me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete dhe njëkohësisht shkaktimin e dëmit personit tjetër, në atë mënyrë që ka bërë zhvendosjen e një pjese të fushës të stadiumit të KF “Ballkan” në sipërfaqe prej 16 ari, të cilën e ndanë nga parcela katastrale nr. 2285 ZK Suhareka pronë e Komunës të cilën pasi e përvetëson ndërton murrin prej betonit në lartësi rreth 50cm dhe vendos rrethojën metalike ashtu që gjatë realizimit të projektit për ndërtimin e objektit të tij afaristë banesor “Gradina”, ndërton rrugën të cilën e shtonë me kupëza betoni dhe parkingun për automjete, pa leje ndërtimi për nevojat e objektit banesorë të ndërtuar si dhe gjatë ndërtimit të objektit afarist banesor përvetëson sipërfaqen rreth 0.50m2 duke kaluar me bazë – themelet e objektit në pronën shoqërore me ç raste Komunës i shkakton dëme të konsiderueshëm në vlerë të paluajtshmërinë së përvetësuar.

-kësodore do të kishte kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtare nga neni 422 par. 1 të KP-së.

I akuzuari K. ...

Me datën 22.07.2013 në Suharekë në cilësinë e personit zyrtar duke shfrytëzuar detyrën zyrtare të tij i tejkalon kompetencat me qëllim të shkaktimin të dëmit të personit tjetër, në atë mënyrë që si drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedisit të Komunës në Suharekë miraton dhe aprovon kushtet e ndërtimit duke plotësuar dhe ndryshuar aktvendimin e pëlqimit urbanistik dhe kushtet e lokacionit nr. 559/2009 të datës 09.12.2009 dhe lëshon leje të re të ndërtimit të cilat nënshkruar si drejtor i kësaj Drejtorie për projektin e ndërtimit të objektit afaristë – banesor “Gradina”, në emër të M. ... dhe në bazë të këtyre ndryshimeve aprovon projektin e tij me ç raste bënë planifikimin e ndërtimit të rrugës dhe autoparkingut për nevojat dhe interesat e objektit privat afarist banesor, në kundërshtim me planin urbanistik detal të qytetit.

-kësodore do të kishte kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtare nga neni 422 par. 1 dhe 2.1 të KP-së.

Të akuzuarit R. ... , H. ... dhe B. ...

Prej muajit korrik të vitit 2013 deri në muajin prill të vitit 2014 në Suharekë, i akuzuari R. ... në cilësinë e personit zyrtar – drejtor të Drejtorisë për Inspektoratë të Komunës, të akuzuarit

Harmon dhe B... në cilësinë të personave zyrtarë – inspektorëve të ndërtimtarisë pranë kësaj Drejtorisë, duke shfrytëzuar detyrat zyrtare nuk i përmbushin detyrat e tyre zyrtare të parapara me ligj ashtu që nuk ndërmarrin veprime për kthimin në gjendje të mëparshme të pjesës së parcelës katastrale nr. 2285 në sipërfaqe prej 16 ari, pronë shoqërore kjo e Komunës së Suharekës të cilën më parë e kishte përvetësuar i akuzuari M... El... dhe pa leje ndërtimi kishte ndërtuar rrugën për nevojat e objektit të tij afarist banesore “Gradina” ashtu që sipërfaqen e përvetësuar nga pjesa e fushës së stadiumit të KF “Ballkan” e ndanë përmes një muri të ndërtuar prej betonit në lartësi prej 50cm si dhe vendosjen e rrethojës metalike në gjatës rreth 50 metra si dhe lejojnë ndërtimin e objektit afarist banesor “Gradina” jashtë projektit të ndërtimit, në pjesën e pronës shoqërore në sipërfaqe prej 0.50m2 me ç raste me dijeni shkelin ligjin lidhur me punësimin zyrtar të tyre, duke i shkaktuar dëme material të konsiderueshëm Komunës në vlerë të paluajtshëmris të përvetësuar.

**-kësodore do të kishin kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtare nga neni 422 par. 1 dhe 2.1 lidhur me nenin 31 të KP-së.**

Sepse Prokurori i Shtetit gjatë shqyrtimit kryesor ka hequr dorë nga akuza.

Përfaqësuesi i Komunës së Suharekës për realizimin e kërkesës pronsoro juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

### Arsyetim

Prokurorja Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzën PP.nr. 154/15 me datën 12.02.2016 kundër të akuzuarve M... El... nga Suhareka, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KP-së, K... F... nga fshati I... Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2.1 të KP-së, H... M... nga fshati I... Komuna e Suharekës, B... K... nga fshati C... Komuna e Suharekës dhe R... F... nga fshati I... Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2.1 lidhur me neni 31 të KP-së.

Në fjalën përfundimtare Prokurori i shtetit ka deklaruar se në mbështetje të nenit 52 të KPP-së, bazuar në parimin e mutabilitetit heq dorë nga ndjekja penale kundër të akuzuarve M... El... nga Suhareka, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KP-së, K... F... nga fshati I... Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2.1 të KP-së, H... M... nga fshati I... Komuna e Suharekës, B... K... nga fshati C... Komuna e Suharekës dhe R... F... nga fshati I... Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2.1 lidhur me neni 31 të KP-së, meqenëse gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale, me asnjë provë nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat

ngarkohen. Meqenëse gjatë rrjedhjes së procedurës në shqyrtimin gjyqësor janë krijuar rrethanat e reja, në bazë të provave të cilat janë siguruar dhe administruar si dhe në bazë të dëshmisë të siguruar nga KF "Ballkan" në Suharekë, është vërtetuar se i akuzuari M... E... nuk ka qenë person zyrtarë në cilësinë e Drejtorit të klubit gjatë periudhës për të cilën është akuzuar se i njëjti të ketë vepruar si person zyrtar. Po ashtu me sigurimin e provave shfajësuese është vërtetuar se i akuzuari K... F... gjatë periudhës për të cilën akuzohet nuk e ka ushtruar pozitën e personit zyrtar si drejtor i Drejtorisë, gjithashtu faktin se të akuzuarit R... F..., H... M... dhe B... K... gjatë periudhës kohore për të cilën janë akuzuar kanë vepruar konformë detyrave dhe autorizimeve të parapara me ligj, i cili fakt është vërtetuar edhe me rastin e shikimit në vendin e ngjarjes ku pjesa kontestuese e cila ka qenë objekti i aktakuzës ka qenë tërësisht e lirë dhe atë në bazë të konstatimit të të akuzuarve gjatë ushtrimit të detyrave të tyre kanë obliguar që pjesërisht ekzekutimin të bëjnë i akuzuari M... E..., e meqenëse kanë vërtetuar se vendimin e plotfuqishëm nuk e ka zbatuar – ekzekutuar plotësisht, të njëjtën e ka ekzekutuar zyrtarisht me mjetet e Komunës. Po ashtu është vërtetuar në bazë të provave të reja se objekti afarist i ndërtuar nga i akuzuari M... E... ka filluar pasi është bërë matja nga eksperti i gjeodezisë e që në rastin konkret nuk ka qenë eksperti – gjeometri i Komunës po matja është bërë nga ana e një eksperti tjetër të pavarur të gjeodezisë, e cila gjithë parashihet me ligjin mbi ndërtimin. Andaj nga këto rrethana, në mungesë të provave heq dorë nga ndjekja penale ndaj të akuzuarve për veprat penale për të cilat ngarkohen me aktakuzë.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar S... G... në fjalë e tij përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën e Prokurori i shtetit e sa i përket kërkesës pasuror juridike do të veprojnë konformë nenit 463 par. 3 të KPP.

Meqenëse Prokurori i Shtetit, gjatë shqyrtimit kryesor është tërhequr nga aktakuza kundër të akuzuarve, konformë nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së ka vendosur si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 454 par.1 të KPP-së.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë në bazë të nenit 463 par. 3 KPP-së.

**GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN**  
**P.nr.27/2016 të datës 19.12.2016**

Sekretarja juridike,  
Valdete Zurnaxhiu

përkthyesja  
Asnije Berisha

Kryetari i trupit gjyqësor  
Raima Elezi

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.